

Kodi i Etikës

Soft & Solution





Përmbajtja:

Vizioni ynë	3
Vlerat tona	3
Përgjegjësitë tona	4
Parimet kryesore	5
Të bësh biznes me ndershmëri dhe integritet	7
Të ndjekësh frymën e ligjit.....	10
Të trajtosh të tjerët drejtësisht	14
Të shmangësh konfliktet e interesit.....	15
Të mbrosh asetet e kompanisë dhe informacionet konfidenciale	17
Kodi i veshjes	21



IN A WORLD OF TECHNOLOGY,
WE MAKE THE DIFFERENCE!

Vizioni ynë

Përkushtimi ynë, suksesi i biznesit tuaj.

Vlerat tona

- Profesionalizëm
- Cilësi
- Bashkëpunim
- Inovacion
- Integritet
- Disiplinë
- Përgjegjshëmri
- Respekt
- Përkushtim
- Besueshmëri

Përgjegjësitë tona

Kodi i Etikës Soft & Solution aplikohet për të gjithë punonjësit.

Çdo punonjës është përgjegjës për leximin, kuptimin dhe respektimin e Kodit të Etikës. Punonjësit të cilët shkelin Kodin e Etikës do të jenë subjekt i masave disiplinore deri në largim nga puna.



Parimet kryesore

Kodi i Etikës bazohet në këto parime kryesore:

- **Të bësh biznes me ndershmëri dhe integritet**
Të bësh biznes me ndershmëri, integritet, profesionalizëm, pa kompromise tregon standarde të larta etike në të gjitha marrëdhëniet e biznesit.
- **Të ndjekësh frymën e ligjit** - Të sigurohet që vendimet e biznesit janë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi ku Soft & Solution operon.
- **Të trajtosh të tjerët drejtësisht** - Të punosh si një ekip me respekt dhe besim për njëri-tjetrin.
- **Të veprosh në interesin më të mirë të Soft & Solution dhe të shmangësh konfliktet e interesit** - Të shmangen situatat ku interesat tona personale ose familjare ndërhyjnë në aftësinë tonë për të marrë vendime të shëndosha në interesin më të mirë të Soft & Solution.
- **Të mbrosh asetet e kompanisë dhe informacionet konfidenciale** - Të mbrohen

vlerat e aseteve të Soft & Solution duke përfshirë asetet fizike, pronësinë intelektuale, informacionet konfidenciale, emrin dhe reputacionin e Soft & Solution si dhe konfidencialitetin e klientëve, furnizuesve dhe të punësuarve tanë.

- **Të bësh pyetje dhe të raportosh shqetësime**

Për të ndihmuar kompaninë në vendosjen e integritetit pa kompromis dhe profesionalizmit, çdo punonjës ka një detyrim për të raportuar shkeljet e mundshme të ligjit, Kodit, dhe udhëzimeve të tjera të kompanisë.

Menaxherët dhe punonjësit që mësojnë për një shkelje të mundshme të ligjit, rregullores, apo politikave ligjore duhet menjëherë të raportojnë tek eprorët e tyre me anë të e-mailit ose mënyrave të tjera të kontaktit që kompania aplikon.

Për shkak se Kodi nuk mund të trajtojë çdo situatë, ju duhet të kërkoni udhëzime sa herë që nuk jeni të sigurt në lidhje me kryerjen e veprimeve të duhura në situata të caktuara, duke kontaktuar me personat

përgjegjës me anë të e-mailit ose mënyrave të tjera të kontaktit që kompania aplikon.

Për çdo pyetje dhe shqetësim të ngritur, do të shqyrtohet çështja me seriozitet dhe do të përcaktohen veprimet e mëtejshme në përputhje me ligjin në fuqi, Kodin e Etikës të Soft & Solution dhe udhëzimeve të tjera të aplikueshme të kompanisë.

Të bësh biznes me ndershmëri dhe integritet



Komunikimi i qartë dhe profesional në Biznes

Ne vlerësojmë komunikimin e qartë, të saktë, të respektueshëm dhe profesional në të gjitha


ndërveprimet tona të biznesit. Çdo komunikim i paqartë dhe joprofesional - goftë verbal ose joverbal - mund të dëmtojë Soft & Solution. Edhe komunikimi me qëllim të mirë mund të keqinterpretohet. Shembuj të komunikimit përfshijnë e-mail, mesazhet me tekst, materialet e prezantimit, si dhe përmbajtjen në mediat sociale dhe faqet e internetit.

Punonjësit e Soft & Solution nuk duhet të përdorin apo hedhin të dhena të papërshtatshme në rrjetet sociale elektronike (facebook, twitter, instagram, etj), të cilat dëmtojnë imazhin e tyre apo të kompanisë.

Ndalohet rreptësisht përdorimi i emaile-ve personale për komunikimin në lidhje me çështjet e punës.

Marrëdhënia e biznesit me klientët, furnizuesit, distributorët dhe të tjerët

Suksesi ynë është i bazuar në marrëdhënie të forta respekti reciprok dhe besimi për klientët tanë, furnizuesit, shpërndarësit dhe të tjerët. Për të ruajtur



këto marrëdhënie, ne i trajtojmë të gjithë personat me të cilët përballemi me mënyrën se si ne presim të na trajtojnë: me drejtësi, ndershmëri dhe respekt.


Në marketing dhe në ndërveprimet tona me klientët ne gjithmonë i përfaqësojmë produktet Soft & Solution në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ne presim që furnizuesit tanë të përshtaten me të gjitha ligjet e aplikueshme, rregulloret dhe Kodin e Etikës të Soft & Solution.

Kontraktorët e pavarur, konsulentët, furnizuesit, shpërndarësit dhe të tjerët që kryejnë biznes me Soft & Solution rrezikojnë ndërprerjen e marrëdhënieve me Soft & Solution në rast të shkeljes së Kodit të Etikës të Soft & Solution.

Përgatitjet e sakta të të dhënave financiare

Të dhënat tona financiare të biznesit dhe të dhëna të tjera formojnë vendimet e biznesit që ne ndërmarrim. Ne jemi përgjegjës për të siguruar se librat dhe regjistrimet financiare janë reflektime të plota, të drejta, të sakta, në kohë dhe të kuptueshme



të operacioneve të kompanisë dhe aktiviteteve të biznesit.

Çdo e dhënë e kërkuar nga marrëveshjet kontraktuale dhe raportet financiare duhet të jetë e saktë, e plotë dhe autorizuar si duhet. Nëse ju viheni në dijeni për të dhënat që mund të jenë të pasakta, të raportoni situatën menjëherë te drejtuesit. Ne nuk e mbështesim përgatitjen e të dhënave të rreme në asnjë rrethanë.

Ne punësojmë auditorët për të mbajtur të dhënat në përputhje me standardet përkatëse të kontabilitetit. Ne duhet të bashkëpunojmë me auditorët dhe sigurojmë që kushdo që vepron nën drejtimin tonë gjithashtu bashkëpunon me auditorët.

Të ndjekësh frymën e ligjit

Ne duhet të veprojmë në një mënyrë që mbështet frymën dhe qëllimin e ligjit. Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve do të kenë pasoja të rënda, si për kompaninë dhe për individët e përfshirë. Prandaj, kur lindin pyetje mbi këto ose çështje të tjera juridike, ju duhet të kërkonti udhëzime nga konsulenti ligjor i kompanisë.



Ligjet e konkurrencës

Ligjet e konkurrencës shërbejnë për të rregulluar mënyrën si kompanitë sillen në treg. Këto ligje inkurajojnë konkurrencën duke ndaluar kufizime të paarsyeshme në tregti. Ligjet kanë të bëjnë në përgjithësi me mënyrat se si kompanitë merren me konkurrentët e tyre, klientët dhe furnizuesit. Shkelja e ligjeve të konkurrencës është një çështje serioze




dhe mund ta vendosin kompaninë dhe individin në rrezik të dënimeve të konsiderueshme penale.

Që ti përmbaheni ligjeve të konkurrencës nuk duhet:

- Të komunikoni me çdo konkurrent në lidhje me çmimin ose çdo term që ndikon në nivelet e çmimeve, apo të prodhimit,
- Të ndani tregje ose klientë,
- Të pajtoheni me një konkurrent për të bojkotuar një biznes, ose
- Të vendosni kushte të papërshtatshme për blerjet ose shitjet.

Prona intelektuale

Të drejtat e pronësisë intelektuale janë vendimtare për të mbrojtur investimet që kompanitë dhe individët bëjnë në zhvillimin e produkteve të reja dhe ideve. Ne mbrojmë pronën tonë intelektuale dhe respektojnë të drejtat e pronës intelektuale të tjerëve.




Nuk mund të kopjojmë, riprodhojmë, ose të transmetojmë materiale të mbrojtura, të tilla si shkrim, vepra arti, muzikë, video, fotografi dhe software nëse nuk kemi autorizim apo licencë.

Ne duhet të përdorim informacionin konfidencial të Soft & Solution apo të tjerëve vetëm për qëllime të biznesit dhe mund ta zbulojmë atë vetëm për ata që janë të autorizuar dhe kanë nevojë të dinë. Edhe pasi kemi lënë punën te Soft & Solution, ne duhet të vazhdojmë të mbrojmë informacionin konfidencial dhe nuk duhet ta përdorim atë pa autorizim.

Për më tepër, ne nuk duhet të kërkojmë ose të inkurajojmë askënd që të përdorin ose të zbulojnë informacion konfidencial, nëse ata nuk janë të autorizuar për ta bërë këtë nga zotëruesi i atij informacioni.

Privatësia

Shumë vende kanë ligje të privatësisë të cilat rregullojnë mbledhjen dhe përdorimin e informacionit personal, i cili përfshin informacione në lidhje me një individ të tilla si një adresë e-mail,




adresa fizike, informacion kartë pagesa ose numri i identifikimit.

Ne jemi të angazhuar për të mbrojtur privatësinë e të gjithëve me të cilët kemi bashkëpunuar, duke përfshirë klientët tanë, konsumatorët dhe punonjësit. Ne besojmë se duke treguar kujdes në mbrojtjen e të dhënave personale ndihmon në ruajtjen e besimit në Soft & Solution dhe në produktet dhe shërbimet tona. Si punonjës të Soft & Solution, secili prej nesh ka përgjegjësi për të përmbushur kërkesat tona të privatësisë dhe sigurisë.

Të trajtosh të tjerët drejtësisht

Një nga parimet tona thelbësore është puna si një ekip, me respekt dhe besim për njëri-tjetrin. Ne përpiqemi që të mbështesim komunikimin e hapur dhe të ndershëm dhe të mbrojmë punëmarrësit nga diskriminimi, ngacmimi, ose praktika të pasigurta.

Ne vlerësojmë lirinë e mendimeve, ideve, pyetjet, dhe shqetësimet. Ne inkurajojmë punonjësit për të




ngritur çështje të lidhura me punën apo shqetësime në situata të ndryshme.

Shanse të Barabarta Punësimi dhe Diversitet

Ne vlerësojmë diversitetin në fuqinë tonë punëtore, si edhe në klientët tanë, furnizuesit, dhe të tjerët. Ne ofrojmë mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë aplikantët dhe të punësuarit. Ne nuk diskriminojmë në bazë të racës, ngjyrës, fesë, besimit fetar, gjinisë, origjinës kombëtare, prejardhjes, moshës, të paaftësisë fizike apo mendore, gjendjes mjekësore, gjendjes civile, shtatzanisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, apo ndonjë karakteristikë tjetër të mbrojtur me ligj vendor, rregullore ose urdhëresë.

Ne ndjekim këto parime në të gjitha fushat e punësimit, duke përfshirë rekrutimin, punësimin, trajnimin, promovimin, kompensimin, përfitimet, transferimin, dhe programet sociale dhe rekreative.

Të shmangësh konfliktet e interesit



Ne kërkojmë të shmangim çdo aktivitet që është ose ka pamjen e një konflikti interesi me Soft & Solution. Ne nuk angazhohemi në aktivitete të cilat konkurrojnë me Soft & Solution apo që ndërhyjnë në kryerjen e duhur të detyrave tona ose përgjegjësi të Soft & Solution. Ne nuk e përdorim informacionin konfidencial të kompanisë, pasuritë e shoqërisë tregtare apo pozicionin në Soft & Solution për përfitime personale. Ne shmangim situata ku interesat tona personale familjare mund të dëmtojnë aftësinë tonë për të marrë vendime të shëndosha në interesin më të mirë të Soft & Solution.

Të gjithë punonjësit duhet të zbulojnë për menaxherët e tyre me shkrim çdo konflikt apo pamjen e një konflikti interesi me Soft & Solution. Zbulimi është i detyrueshëm, në rast të kundërt përbën një shkelje të Kodit të Etikës.


Të mbrosh asetet e kompanisë dhe informacionet konfidenciale

Ne shpenzojmë burime të konsiderueshme për të zhvilluar dhe për të ruajtur asetet e shfrytëzuara për biznesin e kompanisë. Ne kemi përgjegjësi për të



përbushur të gjitha procedurat që mbrojnë vlerën e aseteve të Soft & Solution, duke përfshirë asetet fizike, informacione, emrin dhe reputacionin e Soft & Solution, për të mbrojtur konsumatorët konfidencial dhe të tjerët që kanë besim tek ne.

Mbrojtja dhe asetet fizike




Pasuritë tona fizike përfshijnë objektet, pajisjet, kompjuterat dhe sistemet e komunikimit. Ne duhet të përdorim këto asete kryesisht për biznesin tonë.

Ne duhet të ndjekim procedura të sigurisë për të mbrojtur asetet fizike të kompanisë nga vjedhjet, humbjet, dëmtimet, dhe keqpërdorimet, duke përfshirë qasje të paautorizuara. Raportoni vjedhjen, humbjen, dëmtimin ose keqpërdorimin e aseteve fizike të kompanisë!

Mbrojtja e Informacionit Konfidencial

Informacioni konfidencial është i vlefshëm për Soft & Solution. Ai i jep Soft & Solution një avantazh konkurrenës, ndihmon në ruajtjen e besimit të klientëve tanë dhe mban reputacion të fortë. Informacioni konfidencial përfshin informacion në lidhje me produktet e pa hedhura ende në treg, data e prodhimit dhe më shumë. Gjithashtu përfshihet informacion konfidencial transmetuar me e-mail dhe forma të tjera të medias sociale.

Secili prej nesh ka një përgjegjësi për të mbrojtur dhe mos shpërndarë informacione konfidenciale ose



të dhënat konfidenciale të klientëve tanë dhe partnerëve të biznesit. Ne nuk duhet të zbulojmë ose të përdorim këtë informacion pa autorizim të qartë. Asetet dhe dokumentet fizike duhet të trajtohen në përputhje me politikat e sigurisë së informacionit.


Ruajtja e markës tregtare

Ndër pasuritë më të vlefshme të kompanisë sonë janë markat tregtare. Për të mbrojtur vlerën dhe njohjen e markave tona tregtare, ne kemi udhëzime që specifikojnë se si dhe kur ato mund të përdoren.

Duhet të ndiqni këto udhëzime sa herë që përdorim markën tregtare të kompanisë, qoftë në fushën e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm apo në materialet e përgatitura nga palët e treta, të tilla si agjencitë e marketingut.

Përfaqësimi i Soft & Solution

Vlera e reputacionit tonë dhe emri duhet të mbështetet sa herë që ne përfaqësojmë kompaninë tonë. Në disa raste, Soft & Solution mund të kërkojë nga punonjësit që të veprojnë si përfaqësues të subjekteve të tjera (për shembull, si një këshilltar,



agjent apo rol të ngjashëm). Në ato raste, një punonjës duhet të diskutojë situatën me menaxherin.

Në raste të tjera, kur flitet për biznes ose tema teknologjie në një mjedis publik ose postimi në internet, ju duhet të bëni të qartë se ju po shprehni pikëpamjet tuaja dhe jo ato të kompanisë sonë, nëse ju nuk jeni duke folur si një zëdhëndës i autorizuar i kompanisë.

Kodi i veshjes



Punonjësve u kërkohet që të ndjekin disa standarte të veshjes, duke u nisur nga pozicioni i tyre brenda kompanisë dhe marrëdhënia me persona të tjerë jashtë kompanisë.

Veshja dhe paraqitja e punonjësve të kompanisë Soft & Solution duhet të jetë formale dhe serioze, për tu përfaqësuar sa më denjësisht, gjatë kryerjes së detyrës dhe në takimet e punës. Në mënyrë të veçantë, gjatë orarit zyrtar është e ndaluar mbajtja e veshjeve të papërshtatshme.

Veshje të papërshtatshme konsiderohen: kostumet sportive, pantallonat e shkurtra, minifundet, xhinset, atletet, veshjet me slogane, te zbardhura, te grisura, te ngushta, transparente dhe/ose provokative.



Me konkretisht:

- *Pantallonat dhe kostumet*

Të gjitha pantallonat e dokut, pambukut dhe përbërjeve sintetike janë të përshtatshme, ndërsa ato me përbërje jeans-i, materiali elastik, të shkurtrat apo tre-çerekëshet, si edhe pantallonat e tjera janë të papranueshme.

- *Fundet, fustanet dhe kostumet me funde*

Fustanet dhe fundet e zakonshme me gjatësi mesatare janë të përshtatshme. Gjatësia e fundeve duhet të jetë e tillë që të lejojë uljen dhe qëndrimin e rehatshëm në publik.

- *Këmishat, bluzat dhe xhaketat*

Këmishat e zakonshme dhe bluzat normale janë veshje të përshtatshme për punë, xhaketat normale janë të pranueshme gjithmonë nëse nuk shkelin udhëzimet e mësipërme.



- *Këpucët*

Këpucët e ndryshme të sheshta apo me taka janë të pranueshme, ndërsa atletet apo këpucët shumë të larta nuk lejohen.